



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRIË - OPŠTINA VUČITRN

DI Nr. / Br. 228 / 14  
Nr. i fq. / Br. sh. - 12 -  
Data: / Datum 30.10.2014  
VUSHTRRI - VUČITRN



REPUBLICA E KOSOVËS  
KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

---

STATUTI  
I  
TEATRIT TË QYTETIT  
TË VUSHTRRIË

TETOR 2014

Bazuar në dispozitat e nenit 7 pika 9 të Ligjit për Teatrot Nr. 04/L-106/2012, nenit 12 alinea 12.5 dhe nenit 46 të Ligjit për Institucionet e Kulturës Nr. 02/L-57/2006, nenit 12 “d” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-40, si dhe nenit 41.2 “d” të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur me **30 tetor 2014** miratoi këtë:

**S T A T U T  
T Ë  
T E A T R I T T Ë Q Y T E T I T  
T Ë V U S H T R R I S Ë**

## **KREU I**

### **Neni 1 Dispozitat e përgjithshme Themelimi, Emërtimi dhe Selia**

Me këtë statut rregullohet statusi juridik, veprimtaria, organizimi i brendshëm, organi drejtues, organet ekzekutive, përfaqësimi dhe transparenca e teatrit të qytetit të Vushtrrisë (në tekstin e mëtejshëm: TQV).

### **Neni 2**

TQV-ja është institucion kulturor publik (i themeluar nga Komuna e Vushtrrisë), i cili merret me përgatitjen, organizimin dhe realizimin e shfaqjeve teatrore dhe shfaqjeve tjera skenike.

### **Neni 3**

TQV-ja veprimtarinë, të drejtat dhe përgjegjësitë e veta i realizon në pajtim me dispozitat e Ligjit për teatrin, statutit dhe akteve tjera nënligjore.

### **Neni 4**

1. Emërtimi i teatrit është: "TEATRI I QYTETIT - VUSHTRRI", ndërsa emërtimi i shkurtë është: "TQV".
2. TQV-ja selinë e ka në rr. "Hasan Pishtina" p.n. konkretisht në objektin e Qendrës së Kulturës "Hasan Prishtina" Vushtrri.

### **Neni 5**

TQV-ja ka status të personit juridik, me të gjitha të drejtat dhe përgjegjësitë, të cilat i takojnë me ligj dhe me akte tjera nënligjore.

### **Neni 6**

1. TQV-ja ka vulën e rrumbullakët dhe vulën katrore.
2. Vula e rrumbullakët është me përmasa të diametrit 40 mm dhe ka këtë përmbajtje:
  - a. rrethi i parë – Republika e Kosovës.
  - b. rrethi i dytë – Komuna e Vushtrrisë.
  - c. rrethi i tretë – Teatri i qytetit
  - d. në mes të vulës do të jetë emblema e teatrit.

3. Vula e protokollit është e përmasave 35 x 70 mm dhe ka këtë përmbajtje:

- a. Rreshti i parë – Republika e Kosovës.
- b. Rreshti i dytë – Vushtrrisë, Vushtrri.
- c. Rreshti i tretë – zbrazëtira për shifrën e teatrit në gjatësi prej 10mm, shkronjat “Nr.”, zbrazëtirën për shifrën e përmbajtjes së aktit dhe shifrës së numrit në gjatësi prej 30 mm, si dhe shkronjat “Më” me zbrazëtirë për shënim të datës së pranimit në gjatësi prej 25mm.

#### **Neni 7**

Teatri ka logon e vet e cila dy figura antropomorfe, kurse rreth e rrotull saj përshkrimi, Teatri i Qytetit të Vushtrrisë.

#### **Neni 8**

TQV-ja ka xhirollogarinë e vet në ndonjërin prej bankave të licencuara në Kosovë.

#### **Neni 9**

1. Teatri ushtron këto veprimtari:

- a. vlerësimin dhe vendimmarrjen për të nxitur, mbështetur dhe realizuar veprimtarinë teatrore brenda institucionit;
- b. menaxhimin e sallës së teatrit dhe infrastrukturës së gjithëmbarshme të objektit në pronësi të saj, si dhe menaxhimin dhe mbikëqyrjen e stafit që ka marrëdhënie kontraktuale me teatrin;
- c. zotësi juridike për të lidhur marrëveshje dhe për të hyrë në marrëdhënie detyrimore me palët, për realizimin e veprave dhe aktiviteteve tjera teatrore;
- d. realizon repertorin e verifikuar artistik dhe të qëndrueshëm të shfaqjeve teatrore dhe aktiviteteve tjera të fushës së teatrit;
- e. bashkëpunon me autoritetet publike, institucionet, organizatat dhe asociacionet vendore dhe të huaja në të gjitha çështjet me interes për zhvillimin e teatrit, shkëmbimin e përvojave dhe informacioneve për krijimin e ambientit për zhvillimin dhe avancimin e jetës teatrore në Kosovë;
- f. bashkëpunon me institucionet homologe të vendeve të tjera, bashkëpunon dhe aderon në organizatat dhe asociacionet rajonale e ndërkombëtare nga fusha teatrore, si dhe merr pjesë në aktivitetet e tyre, e veçanërisht në festivale, konferenca, trajnime, dhe lloje tjera shkëmbimesh;
- g. zbaton politikat lokale dhe kombëtare në fushën e artit skenik.

2. Teatri obligohet të realizojë së paku tri premiera teatrore gjatë një viti kalendarik, respektivisht gjatë sezonit teatror, si dhe organizimin e së paku 30 shfaqjeve (reprizave) brenda vitit kalendarik.

## **KREU II**

### **Neni 10**

#### **Struktura dhe funksionimi i teatrit**

1. Organet drejtuese të TQV-së janë:
  - a. Këshilli drejtues,
  - b. Drejtori i përgjithshëm dhe
  - c. Udhëheqësi artistik.

### **Neni 11**

#### **Këshilli drejtues i teatrit**

1. Këshilli drejtues i teatrit, është organ i pavarur, i cili në mes tjerave ushtron edhe këto përgjegjësi:
  - a. Mbikëqyr punën e teatrit;
  - b. Aprovon politikat afatgjata të zhvillimit të teatrit dhe politikën artistike;
  - c. Me propozim të drejtorit të përgjithshëm, miraton Planin vjetor buxhetor të teatrit;
  - d. Me propozim të udhëheqësit artistik dhe në përputhje me buxhetin vjetor miraton programin artistik vjetor të teatrit;
  - e. Shqyrton dhe miraton Raportin vjetor financiar të teatrit;
  - f. Harton dhe propozon statutin, rregulloret dhe aktet tjera nënligjore të teatrit, të cilat i miraton Kuvendi i komunës për teatrin e qytetit;
  - g. Interviston kandidatët dhe zgjedh drejtorin e përgjithshëm dhe udhëheqësin artistik;
  - h. Inicon procedurën dhe shkarkon drejtorin e përgjithshëm dhe udhëheqësin artistik;
  - i. Këshilli drejtues merr vendime me shumicë absolute të votave të të gjithë anëtarëve.

## **Neni 12** **Përbërja e Këshillit drejtues**

1. Këshilli drejtues i teatrit, përbëhet nga pesë anëtarë me mandat katërvjeçar.
2. Këshilli drejtues emërohet dhe shkarkohet nga kryetari i komunës dhe për punën e tij i përgjigjet kryetarit të Komunës së Vushtrisë ose të autorizuarit të tij.
3. Anëtarët e Këshillit drejtues duhet të jenë njohës të mirë të kësaj fushe.
4. Mbledhjen e parë e thërret dhe e udhëheq anëtari më i moshuar i këshillit.
5. Kryetari i Këshillit drejtues zgjedhet në seancën e parë me shumicë absolute të votave të të gjithë anëtarëve.
6. Mënyra e zgjedhjes së kryetarit të Këshillit drejtues përcaktohet me Rregulloren e punës së Këshillit drejtues.
7. Punën e Këshillit drejtues e udhëheq kryetari i Këshillit drejtues.
8. Këshilli drejtues ka dy takime obligative, për të cilat kompensohen me vlerën 50 €, por mund të mbajë deri 6 mbledhje në vit, ndërsa në mbledhje mund të marrin pjesë udhëheqësi artistik dhe drejtori i përgjithshëm pa të drejtë vote.
9. Anëtarëve të Këshillit drejtues u lejohe të jenë pjesë e shfaqjeve teatrale.

## **Neni 13** **Udhëheqësit e teatrit të qytetit**

1. TQV-ja ka dy (2) udhëheqës të lartë ekzekutiv:
  - 1.1. Drejtorin e përgjithshëm;
  - 1.2. Udhëheqësin artistik.
2. Udhëheqësi i teatrit zgjedhet me konkurs publik, të cilin e shpall komuna në pajtim me legjislacionin në fuqi.
3. Mandati i udhëheqësve të teatrit është katërvjeçar (4) me të drejtë rizgjedhjeje edhe për një mandat tjetër.
4. Drejtori i përgjithshëm i teatrit duhet të jetë nga fusha e teatrit ose nga lëmitë tjera të përafërta të kulturës.
5. Udhëheqësi artistik duhet të jetë nga fusha e teatrit.
6. Konkursi për zgjedhjen e udhëheqësve të teatrit shpallet një muaj para skadimit të mandatit të udhëheqësve në detyrë.

7. Emërimin e drejtorit të përgjithshëm dhe udhëheqësin artistik e bën Këshilli drejtues i teatrit.
8. Shkarkimin e drejtorit të përgjithshëm dhe udhëheqësit artistik e bën Këshilli drejtues i teatrit.
9. Këshilli drejtues inicicion procedurën e shkarkimit në rast të:
  - a. papërgjegjësisë në kryerjen e punës dhe mospërmbushjes së detyrave;
  - b. shkeljeve të rënda të dispozitave ligjore dhe statusore gjatë punës;
  - c. dëmtimit të imazhit të teatrit;
  - d. veprave penale;
  - e. performancës së dobët gjatë punës.

**Neni 14**  
**Drejtori i përgjithshëm i teatrit**

1. Drejtori i përgjithshëm i teatrit publik ka këto përgjegjësi:
  - 1.1. bën menaxhimin financiar, administrativ, teknik dhe promovues të teatrit;
  - 1.2. zbaton vendimet e Këshillit drejtues të teatrit;
  - 1.3. propozon organizimin e brendshëm të teatrit tek Këshilli drejtues;
  - 1.4. përfaqëson teatrin brenda dhe jashtë vendit;
  - 1.5. propozon buxhetin vjetor para Këshillit drejtues;
  - 1.6. kërkon, aplikon dhe negocion për marrjen e donacioneve;
  - 1.7. mbikëqyr të hyrat dhe shpenzimet buxhetore, si dhe të donacioneve;
  - 1.8. negocion dhe nënshkruan kontratat dhe marrëveshjet me artistë të pavarur dhe me palë tjera;
  - 1.9. menaxhon mirëmbajtjen dhe sigurimin e ndërtesës së teatrit;
  - 1.10. menaxhon bashkëpunimin në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;
  - 1.11. për punën e tij i përgjigjet dhe i raporton Këshillit drejtues;
  - 1.12. kryen edhe punë tjera të përcaktuara me ligj dhe statut.

2. Drejtori i përgjithshëm për punën dhe detyrat e tij i përgjigjet Këshillit drejtues.
3. Drejtori i përgjithshëm i teatrit duhet të ketë kualifikimin superior nga fusha e teatrit ose nga fusha e menaxhimit kulturor, në rast se ndryshe nuk është përcaktuar me ligj ose akte nënligjore dhe së paku 5 vjet përvojë pune.
4. Në mungesë të drejtorit të përgjithshëm nga puna, atë e zëvendëson udhëheqësi artistik i teatrit.

### **Neni 15** **Udhëheqësi artistik**

1. Udhëheqësi artistik i teatrit ka këto përgjegjësi:
  - 1.1. Propozon politikat artistike të teatrit dhe pas miratimit nga Këshilli drejtues i zbaton ato;
  - 1.2. Në konsultim me drejtorin e përgjithshëm bënë propozimin e repertorit artistik vjetor para Këshillit drejtues të teatrit;
  - 1.3. Repertorin e zgjeruar në përpjesëtim dy për një e paraqet për miratim para Këshillit drejtues të teatrit, duke krijuar hapësira për afirmimin e krijimtarisë kombëtare;
  - 1.4. Udhëheq punën kreative të ansamblit rezident;
  - 1.5. Bën recension për çdo vepër skenike para hyrjes në repertorin vjetor të teatrit;
  - 1.6. Është përgjegjës për realizimin e repertorit vjetor të teatrit;
  - 1.7. Propozon regjisorët dhe i ndihmon drejtorit të përgjithshëm në përzgjedhjen e ekipit artistik të shfaqjeve;
  - 1.8. I propozon drejtorit të përgjithshëm për bashkëpunim artistik me artistë dhe institucione teatrore vendore dhe ndërkombëtare;
  - 1.9. Bashkë me drejtorin e përgjithshëm mbajnë përgjegjësi për çdo shfaqje publike të teatrit;
  - 1.10. Për punën e tij e njofton drejtorin e përgjithshëm, kurse i përgjigjet dhe i raporton Këshillit drejtues
  - 1.11. I lejohe të luaj shfaqje dhe të bëjë regji duke iu shmangur konfliktit të interesit, që nënkupton punë vullnetare për teatrin.



### KREU III

#### Neni 16 Financimi i teatrit

1. Mjetet për punën e teatrit sigurohen nga:
  - a. buxheti i Komunës së Vushtrrisë;
  - b. të hyrat vetanake, të realizuara nga veprimtaria e teatrove;
  - c. donatorët e tjerë.

#### Neni 17

1. Pagat për stafin, mjetet për investime kapitale dhe mjetet për mallra dhe shërbime, menaxhohen nga Komuna e Vushtrrisë.
2. Financimi i projekteve teatrore në përputhje me Planin buxhetor vjetor, derdhen në xhirollogarinë e teatrit dhe menaxhohen nga stafi i teatrit.
3. Menaxhimi i llogarisë së teatrit bëhet nga drejtori i përgjithshëm.
4. Të gjitha pagesat nga xhirollogaria e teatrit kryhen përmes formës së transferit bankar.
5. Drejtori i teatrit mund të shfrytëzojë shumën deri në 99 euro për çdo muaj si para të gatshme. Mjetet e tilla shfrytëzohen për nevojat e domosdoshme të teatrit.
6. Çdo transfer bankar nga xhirollogaria e teatrit, duhet të nënshkruhet në bankë nga drejtori i teatrit.
7. Për administrimin e aseteve financiare zbatohet legjislacioni në fuqi për teatër.
8. Në përputhje me legjislacionin në fuqi, të hyrat, të cilat i krijon teatri nga shitja e të drejtave të pronësisë mbi aktivitetin artistik dhe nga çdo lloj aktiviteti tjetër i lejuar me ligj, shkojnë në buxhetin e komunës.
9. Komuna së paku një herë në vit angazhon një auditor për auditim të pasqyrave financiare për TQV-në.

## **Neni 18** **Njësitë organizative**

1. Në kuadër të teatrit veprojnë:
  - a. Sektori artistik,
  - b. Sektori administrativ dhe
  - c. Sektori teknik.
2. Njësia artistike përfshin Ansamblin rezident dhe artistët tjerë kreativë të teatrit siç janë: aktorët, regjisorët, dramaturgët, skenografët, kostumografët, kompozitorët, disenjatorët e dritave etj.
3. Shërbimi i përgjithshëm administrativ përfshin administratën dhe shërbimet tjera të teatrit, të cilat janë të domosdohme për funksionimin e përditëshëm të teatrit.

## **Neni 19** **Ansambli rezident**

1. Teatri mund të ketë Ansambël rezident, të përbërë prej më së paku 10 aktorë cilësorë, të të gjitha gjeneratave.
2. Me propozim të drejtorit të përgjithshëm dhe udhëheqësit artistik, mund të angazhohen edhe aktorë tjerë me kontratë mbi shërbime të veçanta në projekte të caktuara.
3. Ansamblin e përhershëm e përzgjedh Komisioni profesional i përbërë nga 5 anëtarë: dy prej tyre i cakton teatri, dy themeluesi (Komuna e Vushtrrisë) dhe një anëtar i jashtëm nga fusha e teatrit.

## **Neni 20** **Stafi administrativ dhe teknik**

1. Të gjithë punonjësit e teatrit i nënshtrohen ligjeve në fuqi dhe zbatimit të statutit dhe rregulloreve për punën e teatrit;
2. Punësimi në teatër bëhet me kontratë individuale pune, në përputhje me legjislacionin për rregullimin e marrëdhënieve të punës;
3. Të ardhurat e punonjësve të teatrit përfitohen nga paga dhe shpërblimet që i lejon legjislacioni në fuqi për aktivitetin artistik dhe administrativ të këtij institucioni;
4. Punonjësit e teatrit me kontratë të rregullt pune nuk mund të kryejnë aktivitete të tjera fitimprurëse pa marrë më parë miratimin me shkrim të drejtorit të përgjithshëm të teatrit;
5. Për të gjitha punësimet në teatër duhet siguruar buxhet dhe më pas koordinim me Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport e Komunës së Vushtrrisë.

## **KREU IV**

### **Neni 21**

#### **Rregulloret e brendshme të teatrit**

1. Për organizimin dhe mbarëvajtjen e punës dhe veprimtarisë së teatrit, drejtori i përgjithshëm në bashkëpunim me udhëheqësin artistik, inicion hartimin e rregulloreve të brendshme të teatrit, të cilat i aprovon Këshilli drejtues;
2. Me rregulloret e brendshme të teatrit përcaktohen rregullat, kompetencat, funksionimi i njësive, përshkrimet e detyrave të punës për punonjësit e teatrit, masat administrative etj., nëpërmjet të cilave ushtrohet aktiviteti i përgjithshëm i teatrit;
3. Propozimin e rregulloreve mund ta bëjë Këshilli drejtues dhe drejtori i përgjithshëm, varësisht prej nevojave dhe kërkesave që ka puna në teatër;
4. Rregulloret bazike miratohen brenda gjashtë (6) muajsh nga hyrja në fuqi e këtij statuti.

### **Neni 22**

#### **Lënda arkivore dhe Biblioteka e teatrit**

1. Teatri ka arkivin e vet.
2. Veprimtaria e arkivit të teatrit rregullohet me ligj dhe akte nënligjore.
3. Teatri mund të ketë repertorin e vet artistik të botimeve për botimin e veprave dramatike të autorëve vendorë dhe atyre ndërkombëtarë, për hulumtimin shkencor dhe dokumentues-historik në fushën e dramës dhe teatrit, botimin e katalogëve etj.

### **Neni 23**

#### **Mbikëqyrja**

Mbikëqyrjen e funksionimit dhe menaxhimit të TQV-së e bën Komuna e Vushtrrisë, përmes Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport.

**KREU V**  
**Dispozitat kalimtare**

**Neni 24**  
**Hyrja në fuqi**

Statuti ndryshohet dhe plotësohet, në të njëjtën mënyrë siç është miratuar.

**Neni 25**

Në rast se dispozitat e këtij statuti mund të jenë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për teatrin, përparësi kanë dispozitat ligjore.

**Neni 26**

Ky Statut hyn në fuqi tetë (8) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Shpëtim Zhegrova**  
  
**Kryesuesi i Kuvendit**

